



Zyra e Shtypit
19 prill 2006

NDËRHRYJET NË TREGUN E PARASË

1.1. Operacionet e tregut të hapur

DATA	Injektim likuiditeti	Tërheqje likuiditeti
	R/REPO njëjavore	REPO njëjavore
06.10.2005	---	
13.10.2005	---	
20.10.2005		2,510.00
27.10.2005		1,220.00
04.11.2005		408.00
10.11.2005		2,670.00
17.11.2005		3,050.00
24.11.2005		3,350.00
01.12.2005		3,800.00
08.12.2005		1,720.00
15.12.2005		---
22.12.2005		1,720.00
29.12.2005		505.00

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2005, sistemi bankar, ndryshe nga tremujori paraardhës, u karakterizua nga tepricë likuiditeti. Injektimi në mënyrë të përhershme i likuiditetit në sistemin bankar nga Banka e Shqipërisë në fund të tremujorit paraardhës si dhe rritja e investimit të individëve në instrumentet në monedhën vendase (kryesisht në bono thesari) nxitur nga rritja e diferencës së normave të interesit, ishin faktorët kryesorë që sollën rritjen e likuiditetit të sistemit bankar. Faktor tjetër që kontribuoi në rritjen e likuiditetit të sistemit ishte edhe ndërhyrja në tregun valutor e realizuar nga Banka e Shqipërisë gjatë këtij tremujori.

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

Pavarësisht tepricës së likuiditetit, në fillim të tremujorit në fjalë, në zbatim të politikës së saj monetare, Banka e Shqipërisë vazhdoi ndërhyrjet *me marrëveshje të anasjelltë riblerjeje me maturim njëjavor*, deri në javën e tretë të muajit tetor. Me stabilizimin e situatës së likuiditetit në sistemin bankar dhe të normave të interesit në ekonomi, Banka e Shqipërisë ndryshoi kahun e ndërhyrjeve, duke tërhequr tepricën e likuiditetit nëpërmjet *marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor*. Në vlera mesatare javore, likuiditeti i tërhequr nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve ishte në nivelin 1.9 miliardë lekë.


1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Në mbështetje të ndërhyrjeve me instrumentet e tregut të hapur, për investimin e likuiditeteve të lira, bankat përdorën edhe depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 1,035 milionë lekë në krahasim me 669 milionë lekë në tremujorin e kaluar. Përdorimi më i lartë i kësaj lehtësie u përqendrua në periudhën e fillimit të tremujorit, kur instrumenti i ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë ishte marrëveshja e anasjelltë e riblerjes.

Në kushtet e tepricës së likuiditetit dhe funksionimit të mirë të tregut ndërbankar, instrumenti i kredisë njëditore nuk u përdor pothuajse fare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2005.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2005.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2005.



2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Sikundër tremujorin paraardhës, edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2005, Banka e Shqipërisë ka qenë aktive në tregun e brendshëm valutor. Ndërhyrjet synonin arritjen e objektivit minimum të Rezervës Valutore Neto, të parashikuar në programin monetar. Ndërhyrja ka qenë në kahun e blerjes së valutës dhe është realizuar në gjithë shtrirjen e periudhës së raportimit. Efekti i rezultatit neto nga ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë ka qenë rritje e rezervës valutore me 53.68 milionë euro dhe 38.07 milionë usd me kurs mesatar 122.81 lek/euro dhe 103.09 lek/usd.

2.2 Veprime të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen me Ministrinë e Financave veprime të shitjes së valutës, me qëllim kryerjen e shërbimit të borxhit të jashtëm për qeverinë shqiptare si dhe blerje të valutës që lidhen me përdorimin e fondeve të derdhura në favor të Qeverisë Shqiptare nga organizma financiarë ndërkombëtarë. Respektivisht vëllimi i shitjes së valutës me Ministrinë e Financave llogaritet të jetë 1,867.93 milionë lekë (rreth 70 për qind e kësaj shume përfaqëson shitje të dollarit amerikan), ndërsa blerjet e valutës llogariten të jenë 539.99 milionë lekë. Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 50.09 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)).
